



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
BORDI

VENDIM

Nr.118, Datë 04.05.2021

MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSSH SH.A. LIDHUR ME RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË ERE-S NR.61, DATË 25.02.2021

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. Nr. 232, datë 20.12.2019; neneve 15, pika 1 dhe 16, të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 04.05.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 03.05.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr.61, datë 25.02.2021,

Konstatoi se:

- Shoqëria OSSH sh.a. nëpërmjet shkresës me Nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e kësaj Rregullore duke përfshirë në të tipologjitë e konstatimeve në terren që nuk janë të parashikuara në rregullore si më poshtë:
 - Ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive
 - Përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive
 - Përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive
 - Përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive
 - Përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë
- Në zbatim të nenit 77, pika 9, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE përcaktohet si Autoriteti përgjegjës për miratimin e Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike.
- Gjithashtu shoqëria OSSH sh.a. me shkresën Nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e afateve të parashikuara në nenin 10, të Rregullores, si më poshtë:
Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a., punon me sistem faturimi me cikël 30 ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose

ciklit mujor të lexim/faturimit, si dhe Njoftimi i Furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkeljen.

- ERE me vendimin Nr. 61, date 25.02.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike" vetëm për një ndryshim në nenin 10, duke përjashtuar pjesën tjetër të kërkesës për ndryshimin në nenin 2, të rregullores me arsyetimin që ndryshimet e propozuara në nenin 2, të rregullores, nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.
- Në vijim shoqëria OSSH sh.a., me anë të shkresës nr.3154 prot, datë 31.03.2021, ka kërkuar dhe një herë rishikimin e fillimit të procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshëm në sistemin e matjes së energjisë elektrike" miratuar me vendimin Nr. 61, datë 25.02.2021.
- Për qëllime të analizës së kësaj praktike dhe argumentimeve sa i përket efekteve reale të supozuara nga OSSH sh.a., reflektuar në kërkesën si më lart, si dhe ne përputhje me kërkesat e nenit 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.02.2021, për "Fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", me 30 ditë.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI